



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 367, datë 14.09.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi dhe Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; Objekti: “Gjykimin e çështjes penale për të pandehurit {...}, {...} {...}, {...} {...} akuzuar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 79/dh-22 dhe 278/1 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si më poshtë:

1.1 Kërkesës nr.323 prot., datë 19.07.2021, për caktim gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: I mituri në konflikt me ligjin: {...}; Akuza: “Vjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, më shumë se një herë”;

1.2 Kërkesës nr.349 prot., datë 30.07.2021, për caktim gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: I pandehur: {...}; Akuza: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Entela Gjoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur{...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Miranda Andoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: “Ankim kundër vendimit nr.24 prot., datë 05.02.2021 të prokurorit për mosfillimin e kallzimit penal nr.45, datë 12.01.2021”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi dhe Dritan Banushi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; “Ankim kundër vendimit nr.26 prot., datë 08.02.2021 të prokurorit për mosfillimin e kallzimit penal nr.69, datë 08.01.2021.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi dhe Dritan Banushi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Person i interesuar: {...}, {...}, {...}; Objekti: “Pushim i procedimit penal nr.957/2018”.

II.Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR